

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES, 01-Nr-16-540 PËR NDARJEN E BURSIVE PËR
NXËNËS/E DHE STUDENTË/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS**

E MIRATUAR MË DATËN 31.10.2014

SUHAREKË -2014

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c) lidhur me nenin 17, të Ligjit, Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008"), neneve 15, 27, lidhur, me nenin 28 dhe 29, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2014, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES, 01-Nr-16-540 PËR NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËS/E DHE STUDENTË/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS

Qëllimi;

Neni 1.

Qëllimi i kësaj rregullore është ndryshimi i kriterëve në përcaktimin e radhës së përparësisë për përfitim të së drejtës në bursë për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës.

Neni 2.

1. Neni 3, paragrafi 1, i rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Të gjithë nxënësit/et, e shkollës së mesme studentët/et e rregullt, banorë të Komunës së Suharekës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në ndonjë shkollë të mesme apo fakultet të Universitetit publik në Kosovë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave për shkollim të mesëm dhe shkollim studimor.

2. Neni 3, paragrafi 2, i rregullores bazike fshihet nga teksti i dispozitës:

Neni 3.

Neni 9, paragrafi 2, i rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

KRITERET DHE PRIORITETET

- 1. 9.2** Kriteret dhe prioritet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë; Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak kandidati/ja fiton këto pikë:
 - 9.2.1** Nota mesatare **9 deri në 10**, në fakultet vlerësohet me **20 pikë**
 - 9.2.2** Nota mesatare **8 deri në 8.99**, në fakultet vlerësohet me **15 pikë**
 - 9.2.3** Nota mesatare **7 deri në 7.99**, në fakultet vlerësohet me **10 pikë**
 - 9.2.4** Nota mesatare **6 deri në 6.99**, në fakultet vlerësohet me **5 pikë**
 - 9.2.5** Për kandidatët që kanë **2 (dy)** e më tepër studentë nga e njëjta familje **15 pikë**, ky poentim vlen për aplikuesit që janë studentë
 - 9.2.6** Suksesi i shkëlqyeshëm **4.5 deri në 5** në shkollat e mesme vlerësohet me **20 pikë**
 - 9.2.7** Suksesi shumë mirë **3.5 deri në 4.5** në shkollat e mesme vlerësohet me **15 pikë**
 - 9.2.8** Suksesi i mirë **2.5 deri në 3.5** në shkollat e mesme vlerësohet me **10 pikë**
 - 9.2.9** Për kandidatët që kanë **2 (dy)** e më tepër nxënës nga e njëjta familje **10 pikë**, ky poentim vlen për aplikuesit që janë nxënës.

- 9.2.10 Gjendja ekonomike-financiare (rastet sociale) vlerësohen me 20 pikë
9.2.11 Kandidatët, që nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën me automatizëm
9.2.12 Kandidatët, personat dhe fëmijët e personave me aftësi të kufizuar e vlerësohen me 10 pikë
9.2.13 Fëmijët e ish të burgosurve dhe ish të dënuarve politik, vlerësohen me 10 pikë
9.2.14 Fëmijët e invalidëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 10 pikë
9.2.15 Fëmijët pa një prind vlerësohen me 5 pikë
9.2.16 Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 5pikë
9.2.17 Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 2.5 pikë

2. Nenit 9 të rregullores bazike, pas paragrafit 2, i shtohet paragrafi i ri 3, si vijon;

9.3 Përfashtimet nga e drejta për të fituar bursë janë për këto kategori;

9.3.1 Përfashtohen studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prindërit e punësua.

9.3.2 Përfashtohen studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktivë.

9.3.3 Nga e njëjta familje mund të përfiton bursë vetëm një studentët/et dhe nxënës/et, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.

Neni 4.

1. Neni 10, i rregullores bazike fshihet nga teksti i dispozitës:

Neni 5.

Hyrja ne fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, kjo rregullore hynë ne fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008) dhe nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS

01-Nr-16-7576
Data 31.10.2014.



Kryesuesi i Kuvendit
Refki GEGA